

LIGJI Nr.9901 datë 14/04/2008 "PER TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE"
(i ndryshuar)

STATUTI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

HEIDLJOBS

KREU I THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

NENI 1 DATA E THEMELIMIT, THEMELUESIT DHE EMRI

1 - Sot më datë 03/09/2024 ne themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **HEIDLJOBS**.

2 - Themeluesit e shoqërisë janë:

Z. ILIA DEMKO i datëlindjes **24-09-1998** shtetas Shqiptar, lindur në Korçë, me ID J80924069C mbajtës i dokumentit kartë identitetit me Nr. 033085147 e vlefshme deri më 18-04-2026.

NENI 2

OBJEKTI KRYESOR I VEPRIMTARISË

Shërbime e asistence në punësim. Asistence dhe suport per punedhensesit dhe punemarresit.

TË TJERA

Shërbimi e asistence në punësim. Informim për vende të lira të punës. Asistence për punësim. Këshillim dhe orientim për punë dhe profesion. Informacion dhe këshillim. Udhëzime për punësim, vlerësimi të nevojave, zhvillimi të karrierës apo të profesionit metodika për punësim. Pjesëmarrje në përmirësimin e tregut të punës. Shërbime ndërmjetësimi në të dy kahet për punëdhënësin por edhe për punëmarrësin, apo shërbime ndërmjetësimi të pa lidhura ngushtësisht me çështjet e vetëm punësimit eij. Shërbime për punëdhënësin, kryesish informacion për tregun e punës, shërbime të ofrimit të kandidatëve të mundshëm për rekrutim në punë, informacion për programet e ndryshme të tregut të punës eij. Ndërmjetësimi të përgjithshëm për kompani dhe individë brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. - Vlerësimi dhe përpilimin e kontratave të kompanive para apo gjatë lidhjes së marrëveshjeve. - Shoqëria për përbushjen e qëllimit të saj mund të lidhë marrëdhënie nënkontraktuale me persona të tretë. - "Shoqëria mund të angazhohet gjithashu në çfarëdo lloj aktiviteti tjetër që nuk ndalohet me ligj brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.. Etj.

(brenda kuadrit te dispozitave ligjore shoqeria ka të drejtë të shtojë aktivitetet e nevojshme në listë dhe të kryej çdo biznes të përshtatshëm për arritjen e qëllimit të saj)

NENI 3 KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqerise **HEIDLJOBS SH.P.K** është mbi 20 vjet.



NENI 4
SELIA

Selia e Shoqerise HEIDL.JOBS SH.P.K do të jetë në adresën si më poshtë:
Tirane, Rruga :Shyqyri Bërxolli, Nr ap: 21A, Zona Kadastrale 8380, Nr pasurie 6/472-N20 .

NENI 5
EMRAT E REGJISTRUAR DHE EMËRTIMET TREGTARE

Shoqëria bazuar në Ligjin 9901 datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare" (i ndryshuar neni 4, pika 2 e tij; do të përdorë emërtimin tregtar, HEIDL.JOBS SH.P.K , por dhe shenja të tjera dalluese të veprimitarës duke i regjistruar këto në përputhje me ligjin nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " apo qdo ligj tjetër të posaçëm.

Kreu II
KAPITALI

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

-Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë eshtë në vlerën **100,000 lekë**.
Pjesmarria e themeluesve në kapitalin e shoqërisë në përputhje me kontributin e tyre është si më poshtë:
-Ortaku themelues **ILIA DEMKO** zoteron 1 (një) kuotë me vlerë të përgjithshme **100,000 lekë** që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

NENI 7
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

NENI 8
TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
b) shiitblerjes;
c) trashëgimisë;
ç) dhurimit;
d) qdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III
ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 9
ORGANI VENDIMMARRËS

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqerise që miraton edo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të percaktuara në ligj.
Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
b) ndryshimet e statutit;
c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;

110. Demko


- d) përçaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statut.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jetet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**NENI 10
MËNYRA E THIRRJES SË MBLEDHJES SË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrë datës së parashikuar për mbledhjen asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

**NENI 11
KUORUMI**

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mijte elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoruminit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

**NENI 12
MARRJA E VENDIMEVE**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:

- a) përçaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përçaktimin e shpërblimeve;
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB per te pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

**NENI 13
PËRJASHITIMI NGA E DREJTA E VOTËS**

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënen ose jo të përshtimeve të reja.

2.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Ilia Demko


NENI 14
ADMINISTRIMI

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati maksimal i emëritimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) **Administrator i shoqërisë caktohet Z. ILIA DEMKO me një mandat 5-vjeçar nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.**

NENI 15
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

Administratorët ka të drejtë dhe detyrim:

- a) të kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, se bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryej regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Bisnesit;
- e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndesi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryej detyra të tjera të përaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i/e detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetjeve financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 16
PËRGJEGJËSITË E ADMINISTRATORIT

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajtë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortaku që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarisë së shoqërisë në mëdus;
 - b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përaktuara në këto dispozita;
 - c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
 - ç) të parandalojë dhe mënjanjoë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
 - d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
 3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas

Ilia Demko


pikave 1 e 2 tē këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime tē parregullta. Administratori ka barrën e provës pér tē vërtetuar kryerjen e detyrave tē tyre në mënyrë tē rregullt e sipas standardeve tē kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solida.

4. Në mënyrë tē veçantë, por pa u kuftuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtarë", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
 - c) lejon që shoqëria tē vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë tē gjendjes financiare, duhej tē parashikohej që shoqëria nuk do tē kishte astësi paguese pér tē shlyer detyrimet;
 - d) jep kredi.
- Paditësit kanë tē drejtë tē ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë tē dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund tē ndalojë ngritjen e kërkuesë padisë kundër administratorit gjatë ushtrimit tē detyrës.

KREU IV VITI FINANCIAR-EKSPERTËT

NENI 17 VITI FINANCIAR

Viti finanziar i Shoqerise fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përashtimi, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit të shoqerisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më 31 Dhjetor.

NENI 18 EKSPERTËT

-Eksperti referuar kërkeseve tē legjislatzionit në fuqi ka pér detyrë që tē kontrolloj tē gjithë dokumentacionin kontabel tē veprimitarë ekonomiko tregtare tē shoqerise, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike tē ushtruara prej tij pér rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë tē tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

-Ne perfundim tē kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim pér rezultatin e bilancit finanziar vjetor si dhe pér atë pér kontrollet periodike tē ushtruara, tē cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë ortakëve pér t'i shqyrtau e miratuar mbi bazën e tē drejtës vendimore që ka.

KREU V PRISHJA -RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

NENI 19 PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund tē behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim tē Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave tē falimentimit;
- c) nëse nuk ka kryer veprimitari tregtare pér dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 tē nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- d) me vendim tē gjykatës;

Ne keta rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne tē cilin parashikojne menyren e likuidimit tē shoqerise, duke caktuar 1(një) apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument tē nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtësën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave tē likuidimit në gjendjen e astësisë paguese, me përashtim tē rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim pér emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, pér tē caktuar një likuidues.

NENI 20 RIORGANIZMI I SHOQËRISË BASHKIMI-NDARJA

Shoqëria mund tē ndahet, bashkohet sipas Vendim tē Mbledhjes së Përgjithshme tē Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore tē parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

NENI 21 BAZA LIGJORE

Shoqëria do tē zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje tē plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislatzionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do tē zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë

Ilio Demko
ZNY

tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 22
MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, kompetente do të jetë Gjykata Shqiptare.

O R T A K È T
E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

HEIDI.JOBSS H.P.K

ILIA DEMKO

I.
Emër mbiemër
(nënshtimi)

Ilia Demko

